



KËSHILLI I QARKUT TIRANË
Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, Këshilli i Qarkut Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për pozicionin:

- **Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Tiranë**
- **Kategoria e pagës III-b.**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy Proçedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LEVIZJE PARALELE	10 Dhjetor 2016
Afati për dorëzimin e dokumentave për: NGRITJE NE DETYRE	15 Dhjetor 2016

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Organizimi i punës dhe përcaktimi i detyrave specifike për secilin specialist, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndjekja dhe zbatimi i të gjitha detyrave të caktuara nga Kryesia, Këshilli i Qarkut, dhe Titullari i Institucionit.

Koordinimi i punës për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, e kërkimore në përputhje me dispozitat ligjore. Koordinimi dhe bashkëpunimi me drejtoritë e Këshillit të Qarkut. Mbajtja e korrespondencës mbi çështjet e mbrojtjes dhe administrimit të tokës me institucionet qëndrore dhe me organet e Qeverisjes Vendore të Qarkut. Konfirmimi i çdo korrespondence të përgatitur nga ana e specialistëve të drejtorise së tij. Kontrollimi dhe konfirmimi si dhe përpilimi i materialeve të ndryshme për të cilat kërkohet miratimi i Kryesisë dhe Këshillit të Qarkut.

I- LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-b;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në degët agronomi, gjeodezi, gjeografi;
- b- të kenë përvojë në punë mbi 5 (pesë) vjet si drejtues i nivelit të mesëm;
- c- të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- d- të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore në të cilat përcaktohet organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës. Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik për të koordinuar, kontrolluar, dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve. Aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të behet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **10.12.2016**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.12.2016** Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij.
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për token” (i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” (i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.

- f- Njohurite mbi Ligjin Nr.9948 datë 7.7.2008 “Per shqyrtimin dhe vlefshmerine ligjore të krijimit të titujve te pronesise mbi token bujqesore” (i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës” si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare te internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2- NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NËPUNËS CIVILË PËR PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë IV-a;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës të jetë “Master Shkencor” në degët agronomi, gjeodezi, gjeografi, (diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në degët agronomi, gjeodezi, gjeografi;
- b- të kenë përvojë në punë mbi 5 (pesë) vjet;
- c- të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- d- të kenë njohuri shumë të mira akteve ligjore dhe nenligjore në të cilat percaktohet organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës. Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik për të koordinuar, kontrolluar, dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve. Aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (*për kandidatët nëpunës civilë*);
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi (*për kandidatët nëpunës civilë*);
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- j- Letër reference nga punëdhënësi i fundit (për kandidatët që aplikojnë nga jashtë shërbimit civil).

Dorëzimi i dokumentave për ngritjen në detyrë duhet të behet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **15.12.2015**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **25.12.2015**, Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij.
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”.
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “*Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”.
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “*Për token*” (i ndryshuar) si dhe akteve nëligjore dalë në zbatim të tij.

- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” (i ndryshuar) si dhe akteve nenligjore dalë në zbatim të tij.
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9948 datë 7.7.2008 “Per shqyrtimin dhe vlefshmerine ligjore të krijimit të titujve te pronesise mbi token bujqesore” (i ndryshuar) si dhe akteve nenligjore dalë në zbatim të tij.
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës” si dhe akteve nenligjore dalë në zbatim të tij.
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
- d- Aftësitë analitike dhe të negocimit.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al)
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen zyrtare te internetit te Keshillit te Qarkut Tirane si dhe numër telefononi në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk”, për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare te internetit të Këshillit të Qarkut Tirane si dhe numër telefononi në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk” duke filluar nga data 25.12.2016.